



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR SARANDË

Date, më _____.____.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sherbimi i Evadimit te mbetjeve te rrezikshme spitalore” per
Spitalin Sarandë**

- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 12 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
90524400-0 / Mbledhja, transporti dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore.**

VLERA E FONDIT LIMIT:

**Kuadër 2,584,400.00 (Dy milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind) leke , pa
TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Sarande, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më **poshtë**:

I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

d. *Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojcës 2;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. KANDIDATI/OFERTUESI DUHET TË DORËZOHË:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kriter 2.1.1. Për metoda dhe teknologji të trajtimit të përcaktuara në Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", në VKM nr.798, datë 29.9.2010 "Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore" dhe në Termat e Referencës se DST, ose teknologji ekuivalente,

Operatori Ekonomik duhet të disponoje:

1. Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) ose të tipit B (me kod III.1.B) së bashku me Akt Miratimin përkatës,

si dhe

1.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*)

që të përfshijnë kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte:

- **18 01 01** - Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03);
- **18 01 03** - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet;
- **18 01 04**- Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet (p.sh. veshje, hedhurinat e leukoplasteve, nderesat, veshje për të asgjësuar, pelena etj.)

Kriteri 2.1.2. Per metodën dhe teknologjinë e trajtimit ME INCENERIM, Operatori Ekonomik duhet të disponoje:

1.Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe

2.Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte:

- **18 01 02** - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03);

- **18 01 09** - Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08

Argumentimi për Kriter 2.1.1 dhe Kriter 2.1.2: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe në mbështetje të ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011, "Per mbrojtjen e mjedisit", ligjit Nr.9537, datë 18.5.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme, ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011, "Per lejet e mjedisit" i ndryshuar, ligjit nr.9010, date 13.2.2003 "Per administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta", ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 10463, date 22.09.2011, "Per menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.798, datë 29.9.2010 "Për Miratimin e Rregullores "Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 99, dt.18 shkurt 2005 "Per miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve" ; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 538, date 26.05.2009, "Per licensat dhe lejet, që trajtohen nga/apo nepermjet QKB

dhe disa rregullime të tjera nenligjore të perbashketa” e ndryshuar, Udhëzimin Kombëtar “Për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore” dhe sipas percaktimeve të bëra në Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore”.

2.2 KAPACITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR:

Kriteri 2.2.1. 1. Operatoret ekonomike duhet të paraqesin xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% të fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare*

Argumentimi për Kriteri 2.2.1: Ky kriter, është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, [...]: *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës,....., **si dhe pika 1 dhe 2 e nenit 43**, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatorë ekonomikë dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) **40 % të vlerës së parashikuar të kontratës**, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbimkonsulencë”.*

Vendosja e këtyre kriterëve behet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet paraqitjes së kërkuara me lartë, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

.Përcaktimi i nga AK i kesaj kerkese, lidhet me natyren sensitive te sherbimit ne kontekst te shendetit publik dhe mjedisit, ndaj nga OE kerkohej parametra te larte besueshmerie. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor për besueshmerinë dhe qendrueshmerinë e tij.

2.3 KAPACITETI TEKNIK:

1) **Kriteri 2.3.1** Operatoret ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit , nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në

vlerën në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku e shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi për Kriterin 2.3.1: Ky kriter u vendos në përputhje me gërmes c, të pikes 1 të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, në nenin 55/4 të VKM 285/2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik".

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Kriteri 2.3.2 : Operatori ekonomik duhet të paraqesë të gjitha Çertifikatat si më poshtë vijon:-ISO 9001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent; -ISO 14001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Mjedisit) ose ekuivalent;

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi për Kriterin 2.3.2 Në bazë të nenit 79/1 , të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" si dhe neneve 41/4/a si dhe 44/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;b) efikasitetit të energjisë;c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

Kriteri 2.3.3 : Operatori ekonomik duhet të paraqese Akt Miratimin Higjano –Sanitar respektiv per objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve spitalore, të leshuar nga ISHSH (Inspektorati Shëndetësor Shtetëror).

Argumentimi per Kriteri 2.3.3 Ky kriter bazohet në kërkesat e nenit 10 të ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011, ”Per lejet e mjedisit” i ndryshuar dhe në VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”, në Kreun IV, “Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi Higjano – Sanitar”,ku parashikohet shprehimisht: ".....10.3. Inspektorati Sanitar Shtetëror, pas ekspertimit higjieno-shëndetësor, lëshon aktmiratim higjieno-sanitar për ushtrimin e veprimtarisë."

Kriteri 2.3.4: Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt te lejuar nga AKM per depozitim e produktit final qe del nga asgjesimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave.

Argumentimi Kriteri 2.3.4 : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke qene se, ne baze te Vendimit të Këshillit të Ministarve Nr.798, datë 29.9.2010 për miratimin e rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore” AK si krijues i mbetjeve eshte pergjegjes deri ne hallken e fundit te asgjesimit te mbetjeve spitalore qe krijon, kerkon qe operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë të lidhur me landfill te licensuar per depozitim e produktit final respektiv që del nga proceset e trajtimit/asgjesimit, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave.Gjithashtu ky kriter vendoset në zbatim të vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik nr.701 datë 22.07.2022 si dhe nr.751 datë 04.08.2022.

Kriteri 2.3.5 : Sipas VKM 371, Date 11.06.2014,“Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”, operatori te tregojte se ka te punesuar 1 (nje) inxhinier mjedisi. Per kete qellim duhet te paraqese nje CV, Kopje te Noterizuar te Diplomes se Fakultetit se inxhinierit te mjedisit si dhe kopje te certifikuar nga Drejtoria e Tatimeve te Liste-Pageses se Sigurimeve Shoqerore për periudhën mars – maj 2024 ku te vertetohet qe ka te punesuar inxhinierin e mjedisit.

Kriteri 2.3.6. Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën mars – maj 2024, të jetë mesatarisht 4 (kater) punonjës në muaj.Kjo të dëshmohet me:

- 1- Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën mars – maj 2024
- 2- -Listëpagesat e deklaruara në organet tatimore për periudhën mars – maj 2024

Argumentimi Kriteri 2.3.5, Kriteri 2.3.6 : Ky kriter eshte miratuar dhe vendosur nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me Kërkesat për kualifikim, në përputhje me Nenin 77 pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”,.Ky kriter mbeshtetet edhe ne Rekomandimin e APP Nr. 8197, date 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit mallra, pune, sherbime”. Ky kriter gjen mbeshtetje ne VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” te nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, piken 4, ku percaktohet se: *Për të provuar përshtatshmërinë për*

të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **b)** një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose, **c)** fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kriteri 2.3.7 : Operatori duhet të kete ne pronesi, huapërdorje ose me qira, apo nepermjet cdo menyre posedimi të njohur nga ligji, minimalisht 1 (një) automjet sipas kërkesave të Specifikimeve Teknike dhe Termave të Referencës të ketyre DST. Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

➤ **Për automjetet në pronësi:**

- *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*
- *Leje qarkullimi,*
- *Akt - kolaudimi*
- *Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt - Miratimet Higjenosanitare,*
- *Foto te mjeteve ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese.*

➤ **Për automjetet që nuk janë në pronësi:**

- *Kontratë qiraje ose huapërdorje brenda afatit të vlefshmerise të shoqeruar me aktin e pronesise se qiradhenesit/pronarit.*
- *Leje qarkullimi e mjetit;*
- *Akt kolaudimi;*
- *Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet*
- *Fotot e mjeteve dhe Akt – Miratimet Higjenosanitare.*

Automjetet e perdorura duhet qe te plotesojne karakteristikave te mjetit te bazuara ne piken 8.8/c dhe shtojces 4, te VKM nr.798, date 29.09.2010 Per miratimin e rregullores, ” Per administrimin e mbetjeve spitalore”si edhe pike 9.3.3 te Udhezuesit Kombetar ” Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore”.

Argumentimi per Kriteri 2.3.8 : Meqënëse shërbimi objekt kontrate, parashikon ndër elementet e tij edhe transportin nga AK, në ambientet e trajtimit të OE, dhe te produkti final nga ambientet e OE ne landfill, në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion automjetet për të përmbushur elementet e kontratës (transportin), të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kriteri 2.3.8: Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, apo nepermjet cdo menyre posedimi të njohur nga ligji, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të

gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe te VKM-se Nr. 798, date 29.09.2010, per miratimin e rregullores “Per administrimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

- a. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope 1 dhe impiant back up me të njëjtën metodë;
- b. Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1 dhe impiant back up me të njëjtën metodë;
- c. Makineri për larjen e kontenierëve cope 1 dhe makineri back up të tillë (vetem ne rastin kur do te perdoren konteniere te riperdorshem);

Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- a) Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
- b) Të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
- c) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;
- d) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.

Ne rast te perdorimit te konteniereve njeperdorimsh, te paraqitet nje vetedeklarim ne te cilin te deklarohet se: kontenieret qe ofrohen nga OE, jane brenda standarteve ligjore te kerkuara ne fushen e mbetjeve te rezikshme spitalore.

Per te vertetuar permbushjen e ketij kriteri OE, duhet te paraqese:

-Dokumentacionin per vertetimin e pronesise ose te marrjes me qera (ku afati i marrjes me qera te jete minimalisht me afatin e ekzekutimit te ketij objekti prokurimi);

Argumentimi per Kriteri 2.3.9: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Ne baze te ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011, VKM Nr. 798 date 29.09.2010, ligjit Nr. 8934 date 05.09.2002, VKM Nr. 99 date 18.02.2005, impiantet për realizimin e trajtimit me sterilizim dhe asgjësimit me incenerim te kategorive te caktuara te mbetjeve spitalore, jane paisjet baze per realizimin me sukses te ketij sherbimi. Gjithashtu, AK, ne planifikimin e menaxhimit te mbetjeve spitalore, ka parashikuar që në dallim nga kontenitorët për të mprehtat dhe qeset, që janë amballazhi i drejtpërdrejtë i mbetjeve spitalore që duhet të jenë njëpërdorimëshe, kontenitorët plastike të medhenj që duhet të vihen në dispozicion nga Operatori Ekonomik fitues që shërbejnë për transferimin dhe transportin e mbetjeve spitalore, duhet të jene shumeperdorimesh dhe kjo nuk eshte nje zgjedhje subjektive e AK, por e ndikuar nga shkaqet ligjore, ekonomike dhe mjedisore sic percaktohet nga Ligji nr. 10 463, date 22.9.2011 neni 6, Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” nenet 7 dhe 33 si dhe ne edhe në Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore i nxjerrë në zbatim të VKM Nr. 798, date 29.09.2011.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

I. SPECIFIKIMET TEKNIKE

Per realizimin e sherbimit per trajtimin dhe asgjesimin e mbetjeve spitalore, bazuar ne kerkesat e legjislacionit ne fuqi, operatori ekonomik duhet te siguroje:

1- Furnizimin me bazen materiale te nevojshme per realizimin e ndarjes ne burim dhe magazinimin provizor te mbetjeve spitalore deri ne terheqjen e tyre, sipas kerkesave per secilin kod te mbetjeve spitalore.

Per kete qellim, Operatori Ekonomik duhet te vëre ne dispozicion te AK, konteniere plastikë, qese plastike, kuti për të mprehtat, për përmbushjen e ambalazhimit referuar tipologjive të mbetjeve. Baza materiale duhet të jetë sipas standardeve dhe kërkesave të VKM nr. 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, të Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore si dhe të përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata Boterore e Shendetesise.

Kompania duhet te realizoje nje furnizim të përshtatshëm në cdo kohe me materiale ndihmese te nevojshme per grumbullimin e perkohshem te mbetjeve.

I. Materialet ndihmese duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

Kuti për të mprehtat (brenda diapazonit 3 – 12 Litra)

- Të jenë në përputhje me standardin SSH EN ISO 23907 – në variantin më të fundit të përditësuar (ose ekuivalent) “Mbrotjtja nga dëmtimi prej objekteve të mprehta - Kërkesat dhe metodat e testimit - Kontenierët (enët) e objekteve të mprehta”.
- Hapja të jetë aq e gjerë sa të lejojë që mbetjet spitalore të hidhen në kuti duke vepruar vetëm me një dorë. Në varësi nga masa e mbetjes spitalore për të cilën është projektuar kutia për të mprehtat, hapja në kushte normale të përdorimit, të pengojë daljen/nxjerrjen e përmbajtjes;
- Nëse janë të pajisur me kapakë të lëvizshëm, të jenë të projektuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e nevojshme shtyrja me dorë e materialeve në kuti;
- Të jenë të tilla që të mbyllen në mënyrë të sigurt dhe të mbeten të mbyllura gjatë transportit;
- Pasi janë mbyllur, të gjithë llojet e kutive për të mprehtat të mos lejojnë rrjedhje;
- Të jenë të pajisura me dorezë që nuk është pjesë e pajisjes mbyllëse;
- Të jenë pa përbërje polivinilkloridi (PVC), të ndezshme dhe të djegshme në mënyrë të sigurt (Polypropilene);
- Të jetë e shënuar në mënyrë të dukshme me një vijë horizontale për të treguar kur kutia e të mprehtave është e mbushur ndërmjet 70% dhe 80% të vëllimit të saj maksimal, së bashku me fjalët "KUJDES - MOS E MBUSHNI MBI VIJË";
- Të jenë me ngjyrë të verdhë apo kombinim i të bardhës dhe të verdhës; dhe për të mprehtat e ndotura nga citotoksikë, me kapak ngjyrë të kuq ose të purpurt me simbolin e mbetjeve citotoksike;
- Të shkruhet qartë në to me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa. ku të lexohen qartë fjalët "RREZIK: TË MPREHTA TË NDOTURA" dhe të përmbajnë simbolin e biohazardit në etiketë.

Koshat plastikë (brenda diapazonit 40 – 60 Litra)

- Të jenë në përputhje me standardin SSH EN ISO 23907 – në variantin më të fundit të përditësuar (ose ekuivalent)
- Të tillë që të mbyllen në mënyrë të sigurtë;
- Rezistent ndaj rrjedhjes, thyerjes nga goditja dhe shpimet;
- Të jenë pa përbërje polivinilkloridi (PVC), të ndezshme dhe të djegshme në mënyrë të sigurt (Polypropilene);
- Të shkruhet qartë në to me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa perkatese sipas pikes II të këtyre Specifikimeve “ETIKETIMI”.

Shënim: Në rastin e koshave plastikë shumëpërdorimësh, duhet të garantohet larja dhe dezinfektimi i tyre në makinerinë përkatëse të specializuar dhe të vijne të shoqëruar me qeset plastike përkatëse.

II. ETIKETIMI

Çdo enë e mbetjeve spitalore duhet të ketë në pjesën e jashtme të saj një etiketë e cila të përmbajë shenjën ndërkombëtare të Biohazardit sipas modelit me përmasat e specifikuar në më poshtë:

Etiketa të prodhohet me material që u reziston rrezeve UV, ujit dhe të jetë ngjyëse, ose të jetë e stampuar në një pozicion të dallueshëm të enës që lejon që të dhënat në etiketë të lexohen lehtë.

PËRMASAT E SIMBOLIT

Tipi i kontenierit të mbetjeve spitalore

Përmasat e simbolit

Për të mprehtat:

- | | |
|--|------------------------------|
| i. me kapacitet prej më pak se 2 litra | jo më pak se 40 mm x 40 mm |
| ii. me kapacitet prej 2 litra ose më shumë | jo më pak se 75 mm x 75 mm |
| iii. të tjerë: | jo më pak se 150 mm x 150 mm |



SIMBOLI NË ETIKETË

Ngjyrat e simbolit të jenë si më poshtë:

Konturet – ngjyrë e zezë

Fusha – ngjyrë e bardhë ose ngjyra parësore e enës

Fjalët dhe karakteret – ngjyrë e zezë

Shenja ndërkombëtare e Biohazardit – ngjyrë e zezë

PËRMBAJTJA E ETIKETËS

Çdo kontenier i mbetjeve spitalore, pasi mbyllet dhe vulozet, të identifikohet me një etiketë që të vendoset në pjesën e përparme të kontenierit dhe që të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- i. Identifikimin: Mbetje Spitalore
- ii. përcaktimin: “Infektuese”

- iii. fjalën sinjalizuese: Rrezik
- iv. njoftimin e rrezikshmërisë: “Mund të shkaktojë infeksion”
- v. Kodin sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve: 18.
- vi. Gjendjen: e ngurtë ose të lëngët;
- vii. Datën e fillimit dhe përfundimit të grumbullimit;
- viii. Sasinë në kg ose litra;
- ix. Prodhuesin / Kodin Unik / Adresën / Personin përgjegjës (Emër/mbiemër/firmë / nr.telefoni

PER ORIENTIM-MODEL ETIKETE:

MBETJE SPITALORE	Infektuese
RREZIK! Mund të shkaktojë infeksion	
RRYMA E MBETJEVE: 18. (sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve)	
GJENDJA: NGURTE <input type="checkbox"/> LËNGSHME <input type="checkbox"/>	
GRUMBULLIMI I MBETJEVE:	
DATA E FILLIMIT: ... / ... / 20 ...	
DATA E PËRFUNDIMIT: ... / ... / 20 ...	
SASIA: (.....) (kg ose l)	
PRODHUESI:	
KODI UNIK:	
ADRESA:	
PERSONI PËRGJEGJËS: (emër/mbiemër/firmë)	
Nr. Telefoni:	

Etiketat për vendin e magazinimit të AK

Kontraktori duhet të sigurojë për AK etiketat që duhet të vendosen dukshëm si shenja e rrezikut në dyer, porta ose mbulesa, sipas modelit të mëposhtëm:



III. Terheqja e mbetjeve nga vendgrumbullimi dhe transportin deri ne vend trajtim.

Operatori ekonomik duhet te siguroje grumbullimin e konteniereve me mbetje ne pikat e perkohshme te magazinimit te autoriteteve shendetesore si dhe transportin e tyre ne impiantin e trajtimit me mjetet e posacme te transportit.

Njekohesisht me grumbullimin e konteniereve duhet te vihen ne dispozicion konteniere te rinj te gatshem per tu perdorur.

Mjeti i transportit, qe sherben per dergimin e konteniereve te rinj bosh, nuk duhet te jete i njejte me ate qe perdoret per grumbullimin e konteniereve te mbushur me mbetje, pra kontenieret me mbetje dhe kontenieret e rinj bosh nuk mund te transportohen me te njeften mjet transporti. Transporti i konteniereve duhet te kryhet ne menyre qe te sigurohet integriteti dhe pastertia e tyre, ne perputhje me rregullat e higjenes dhe sigurise.

Automjetet e perdorura per transportin e mbetjeve spitalore duhet te kenë karakteristikat e mëposhtme:

Çdo automjet që transporton mbetje spitalore të rrezikshme:

1. Duhet të jetë lehtësisht i identifikueshëm gjatë transportimit të mbetjeve me simbolin dallues ndërkombëtar të rrezikut të mbetjes spitalore që transportohet. Simboli të mos jetë më i vogël se 250 mm X 250 mm.
2. Duhet të ketë një panel paralajmërues, të vendosur dukshëm në anën e përparme dhe të pasme të automjetit për të treguar transportin e mbetjeve spitalore. Paneli paralajmërues i rrezikut (Varianti A ose B më poshtë) të jetë në pjesën e përparme dhe të pasme të automjetit të transportit të mbetjeve spitalore në një pozicion që nuk mbulon asnjë dritë, targën ose shënime apo shenja të tjera të kërkuara ligjërisht. Të dy variantet janë të pranueshme dhe zgjedhja varet kryesisht nga hapësira në dispozicion.
3. Të sigurojë kontakt minimal të njeriut me kontenierët e mbetjeve spitalore gjatë ngarkim-shkarkimit të tyre.
4. Të ketë një ndarje midis kabinës së shoferit dhe trupit të automjetit.
5. Të ketë një sistem të përshtatshëm për sigurimin e ngarkesës gjatë transportit.
6. Të mbahet i kyçur përveç kur ngarkohet dhe shkarkohet.
7. Të jetë projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që të mos lejojë derdhjet e mbetjeve të ngurta dhe të lëngta

Specifikimet:

- **Materiali:** pjtatë alumini (1-2 mm e trashë)
- **Veshja:** sfond reflektues
- **Ngjyrat:** konturi – i zi
sfondi – i verdhë
fjalët – të zeza
- **Përmasat:** fjalët ≥ 40 mm në lartësi
- **pjata (Versioni A):** gjatësia ≥ 200 mm; gjerësia ≥ 750 mm
- **pjata (Versioni B):** gjatësia ≥ 340 mm; gjerësia ≥ 500 mm

Varianti A

**CAUTION! CLINICAL WASTE
KUJDES! MBETJE SPITALORE**

Varianti B

**CAUTION!
CLINICAL WASTE**

**KUJDES!
MBETJE
SPITALORE**

Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet të realizojë ngarkimin dhe shkarkimin e koshave/kontenierëve në dhe nga makina e grumbullimit. Personeli i trajnuar dhe caktuar për këto qëllime duhet të përdorë veshje të përshtatshme mbrojtëse si doreza, çizme, përparëse dhe maskat.

IV. Dezinfektimin

Operatori Ekonomik duhet të realizojë dezinfektimin:

- Të kontenierëve për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve spitalore duhet të dezinfektohen para dhe pas çdo terheqje.
- Mjediseve për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve të caktuara nga AK ku realizohet terheqja e kontenierëve, të cilët duhet të dezinfektohen në intervale të rregullta.

V. Trajtimin e mbetjeve spitalore dhe asgjësimin final të produkteteve të trajtimit, sipas kërkesave të legjislativës në fuqi

Kontraktori, në cilësinë e marrësit të mbetjeve spitalore duhet të jetë i pajisur gjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit me Licencë III 2 B, Leje të Mjedisit të tipit A dhe/ose B sipas kategorisë së mbetjeve dhe Akt-Miratim Higjieno-Sanitar, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Trajtimi i mbetjeve spitalore kryhet nga subjektet e licencuar, në impiantet për trajtimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme, që duhet të jenë të licensuar dhe të respektojnë kërkesat sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat.

Pajisja me leje mjedisore dhe licensë përkatëse e operatorëve ekonomik dhe impianteve për trajtimin e mbetjeve është kusht për kualifikimin. Lejet Mjedisore përkatëse duhet të përmbajnë të dhëna të detajuara që identifikojnë qartë: metodën e trajtimit, teknologjinë e impianteve, llojin dhe tipin e impiantit, vendndodhjen, kapacitetet, ciklet dhe proceset e punës së impianteve.

A. Trajtimi i mbetjeve spitalore të kryhet me metoda të standartizuara. Proceset bazë për trajtimin e mbetjeve spitalore janë si vijon:

- i. termik: ky proces përdor energjinë termike për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- ii. kimik: ky proces përdor dezinfektantë si dioksid klori i tretur, hipoklorit natriumi, acid peracetik, solucion gëlqereje, gaz ozoni ose kimikate të thata inorganike (p.sh. pluhur oksid kalciumi) për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- iii. mekanik: ky proces përfshin copëtimin, bluarjen, përzierjen dhe ngjeshjen me qëllim përmirësimin e shkallës së transferimit të nxehtësisë, depërtimit të avullit dhe kontaktit me dezinfektantin kimik si dhe për të zvogëluar vëllimin e mbetjeve, për t'i bërë mbetjet e trajtuara të panjohshme ose për të shmangur dëmtimin fizik në rastin e mbetjeve të mprehta të trajtuara. Ky proces nuk mund të shkatërrojë patogjenët, por plotëson proceset e tjera të trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme.

B. Llojet e pranueshme të teknologjive për trajtimin e mbetjeve spitalore

a. Teknologjitë termike pa djegie

- i. Autoklavat – trajtimi kryhet përmes nxehtësisë së mbetjeve nga avulli nën presion.
- ii. Sistemet e integruara (ose autoklava të avancuara apo autoklava hibride) - kombinojnë trajtimin me avull me procese të tjera mekanike si ngjeshje, copëtim, grirje, para, gjatë ose pas trajtimit;
- iii. Trajtimi me nxehtësinë e fërkimit - përdor nxehtësinë e fërkimit të plotësuar nga ngrohësit me rezistencë për të nxehur mbeturinat, ndërkohë mbetjet copohen në kokrriza të thata.
- iv. Sistemet e nxehtësisë së thatë – nxehtësia aplikohet pa shtuar avull ose ujë. Mbetjet nxehen nëpërmjet përcimit, konveksionit natyror ose të detyruar dhe/ose rrezatimit termik.

b. Teknologjitë kimike

- i. Hidroliza alkaline - shndërron mbetjet patologjike në një tretësirë ujore të dekontaminuar.

c. Teknologjitë me djegie

- i. Inceneratorët – trajtimi bazohet në procesin e oksidimit të thatë dhe temperaturës së lartë që kthen mbetjet organike dhe të djegshme në lëndë inorganike dhe të padjegshme dhe që rezulton në një reduktim të ndjeshëm të vëllimit dhe peshës së mbetjeve”.

C. Per procesin e trajtimit te mbetjeve spitalore, kontraktori dokumenton dhe regjistron në një regjistër të posacëm, transferimet e mbetjeve siç përcaktohet në në VKM nr. 371, datë 11.6.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre” i ndryshuar, VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit” i ndryshuar si dhe në Urdhërin e Ministrit të Mjedisit nr.135, datë 16.4.2015 “Për miratimin e mënyrës së administrimit të formatit të regjistrit të transfertave individuale dhe të regjistrikombëtar të transfertave, si dhe mënyrën e administrimit të tyre”.

D. Asgjesimi i tepricave që rezultojnë nga trajtimi i mbetjeve spitalore

Kontraktori është përgjegjës për tu siguruar për evadimin përfundimtar me asgjesim të tepricave që rezultojnë pas trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Procesi i asgjesimit të tepricave, mund të realizohet nga vetë Kontraktori, nëse është i pajisur me Leje Mjedisore dhe Licensën përkatëse për këtë proces, ose nga subjekte të tjera të pajisur me Leje Mjedisore e Licensë përkatëse, me të cilët Kontraktori duhet të ketë kontratë aktive në momentin e dorëzimit të ofertave dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Kuadër do të jete përgjegjës që të mundesoje që ky shërbim të vazhdoje sipas standarteve dhe rregullave në fuqi.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë të sterilizuara:

- a) mund të dërgohen për rikuperim në impiantet termike të prodhimit të energjisë;
- b) mund të asgjësohen në impiantet e djegies së mbetjeve urbane ose në impiantet speciale të djegies së mbetjeve;
- c) nëse nuk ka impiante sipas germës a) dhe b), mund asgjësohen në landfille për mbetjet jo të rrezikshme.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë HI

Hiri nga incineratori dhe tepricat e tjera të ngurta të prodhuara, depozitohen në landfille për mbetje jo të rrezikshme, nëse testet vërtetojnë se nuk paraqesin rrezik sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për mbetjet. Në të kundërt, trajtohen si mbetje të rrezikshme dhe mund të depozitohen në landfille për mbetje të rrezikshme, ose të magazinohen nga Kontraktori deri sa të kontraktotë landfillin e mbetjeve të rrezikshme, ose në pamundësi të disponueshmërisë së një landfilli të mbetjeve të rrezikshme, të realizojë procedurat e nevojshme për eksportin e tyre, dhe ti dokumentojë procesin.

Autoriteti Kontraktor për procesin e asgjësimit të tepricave të mbetjeve spitalore, kur asgjësuesi i tyre është i ndryshëm nga Kontraktori, dokumenton dhe regjistrohen në një regjistër minimalisht të dhënat e mëposhtme:

- a. Të dhënat e kontaktit (emër, mbiemër, adresë, nr. telefoni) të dorëzuesit të mbetjeve spitalore;
- b. Llojin e mbetjeve të trajtuara dhe kodin përkatës sipas katalogut shqiptar të mbetjeve;
- c. Sasinë e dorëzuar të tepricave të mbetjeve (në kg);
- d. Datën e dorëzimit;
- e. Numrin e lejes së mjedisit, numrin e licencës III.2.B dhe Kodin unik të dorëzuesit të tepricave të mbetjeve spitalore të trajtuara të dorëzuara për asgjësim;

Në çdo rast të sipërpërmendur mbahet parasysh parashikimi i nenit 44, të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, për të përjashtuar nga depozitimi në landfill mbetjet spitalore të patrajuara fillimisht në impiante të trajtimit të mbetjeve spitalore.

B- TERMAT E REFERENCËS

OBJEKTI DHE QËLLIMI I SHËRBIMEVE:

Objekti: Menaxhimi i integruar i mbetjeve spitalore për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Sarandë

Qëllimi i shërbimit: Realizimi i proceseve të grumbullimit, transportit, magazinimit të përkohshëm, trajtimit të mbetjeve spitalore si dhe evadimit për asgjësim të tepricave që rezultojnë nga trajtimi, me qëllim që i gjithë procesi i menaxhimit të mbetjeve spitalore të sigurojë zvogëlimin e rrezikshmërisë së tyre dhe optimizimin e grumbullimit, transportit dhe trajtimit të tyre deri në evadimin përfundimtar me asgjësim të tepricave.

DETYRAT:

Operatori Ekonomik fitues duhet të realizojë shërbimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve spitalore, sipas kontratave përkatëse të shërbimit që do të lidhen nga AK.

Elementët përbërës të shërbimit dhe detyrat specifike që duhet të kryhen nga Operatori Ekonomik fitues (Kontraktori), janë si vijon:

1. Sigurimi për Autoritetin Kontraktor i bazës materiale për Mbetjet Spitalore

Kontraktori do të jetë përgjegjës, që gjatë të gjithë periudhës së shërbimit, brenda vlerës së shërbimit të kontraktuar dhe sipas nevojës së AK, të furnizojë AK me bazën materiale të nevojshme që do të përdoren nga AK për ambalazhimin etiketimin dhe grumbullimin e vecantë dhe e mbetjeve spitalore të prodhuara sipas rrymave përkatëse.

Grumbullimi i vecantë është ndarja në burim nga vetë AK e mbetjeve spitalore të rrezikshme nga ato të parrezikshme, dhe të mbetjeve të rrezikshme në rryma të vecanta sipas kodeve të paragrafit 18, të VKM nr.402, datë 30.06.2021 "Për miratimin e katalogut të mbetjeve" (Shtojca 1). Mbetjet spitalore të parrezikshme, që në mënyrë të vullnetshme apo të pavullnetshme përzihen me mbetje spitalore të rrezikshme, trajtohen si mbetje të rrezikshme.

Baza materiale për ambalazhimin e mbetjeve spitalore duhet:

- i. Të mos lejojnë rrjedhjen, të jenë të papërshkueshme ndaj lagështirës dhe të forta për të parandaluar grisjen, çarjen apo shpimin në kushte normale përdorimi.
- ii. Të mos ripërdoren nëse janë një përdorimëshe dhe të pastrohen dhe dezinfektohen pas çdo përdorimi nëse janë disa përdorimshe apo në rast ndotje me ndonjë mbetje spitalore.
- iii. Të sigurojnë mbyllje të sigurtë, në një mënyrë që të parandalohet derdhja e mbetjeve spitalore gjatë transportit.
- iv. Të jenë të padëmtuara dhe pa ndonjë defekt tjetër që mund të çënojnë përdorimin e tyre të sigurt.

Kodi i ngjyrave të bazës materiale për mbetjet spitalore duhet të jenë si më poshtë:

Mbetja (Kodi)	Ena mbajtëse
18 01 01	Kuti të posacme për të mprehtat njëpërdorimshe – kombinim i te verdhes me te bardhen. Me kapak te kuq ose lejla për të mprehtat të ndotura me citotoksike
18 01 02	Kosh i verdhë një ose shumëpërdorimësh i pajisur me qese të verdha me mbyllje hermetike.
18 01 03	Kosh i verdhë një ose shumëpërdorimësh i pajisur me qese të verdha me mbyllje hermetike
18 01 04	Kosh i verdhë një ose shumëpërdorimësh i pajisur me qese të verdha me mbyllje hermetike
18 01 09	Kuti të posacme te verdha

Baza materiale për ambalazhimin e mbetjeve spitalore duhet të të plotësojnë kërkesat përkatëse të përcaktuara në Specifikimet Teknike. Para magazinimit të përkohshëm nga AK në pritje të tërheqjes nga Kontraktori, kontenierët e mbetjeve spitalore të rrezikshme mbyllën dhe etiketohen sipas rrymave të vecanta. Materialet etiketuese duhet të vihen në dispozicion nga Kontraktori dhe duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara për to në Specifikimet Teknike.

Magazinimi i përkohshëm nga AK i mbetjeve spitalore të rrezikshme bëhet në një vend të caktuar, që përmbush kërkesat e posacme të përcaktuara në VKM përkatëse dhe të etiketuar posacërisht për këtë qëllim. Materialet etiketuese duhet të vihen në dispozicion nga Kontraktori dhe duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara për to në Specifikimet Teknike.

Nëse AK prodhon mbetje patologjike kodit 18 01 02, Kontraktori duhet të japë në përdorim dhe të instalojë frigorifer në ambientet e magazinimit të përkohshëm të AK me kapacitet të mjaftueshëm për nevojat e AK përkatëse dhe temperaturë - 18 C për ruajtjen e mbetjeve patologjike deri në momentin e marrjes në dorëzim nga Kontraktori.

2. Marrja në dorëzim dhe transportimi i Mbetjeve Spitalore

2.1 Frekuenca

Frekuenca e tërheqjes dhe marrjes në dorëzim të mbetjeve nga Kontraktori sipas rrymave përkatëse do të jetë si vijon:

Frekuenca e tërheqjes dhe marrjes në dorëzim të mbetjeve nga Kontraktori do të jetë të paktën dy here në muaj ose çdo pesëmbëdhjetë dite.

Kontraktori në momentin e marrjes në dorëzim duhet të pranojë për transportim vetëm mbetjet spitalore që janë ambalazhuar, etiketuar me materialet e dorëzuara nga Kontraktori në përputhje me kërkesat e Specifikimeve Teknike, si dhe janë magazinuar nga AK në përputhje me kërkesat e VKM të posaçme për rregullat e menaxhimit të mbetjeve spitalore.

Pas verifikimit si më sipër të plotësimit të kërkesave për ambalazhimin, etiketimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme, si dhe kushtet e magazinimit nga AK, Kontraktori merr në dorëzim mbetjet spitalore për t'i transportuar në vendin e trajtimit.

2.2 Peshimi

Peshimi i mbetjeve do të kryhet nga një peshore e kolauduar nga Drejtoria e Metrologjisë, që duhet të vihet në dispozicion nga ana e Kontraktorit, i cili duhet gjithashtu ta shoqërojë me certifikaten e kolaudimit përkatës. Mbetjet e destinuar për tu dorëzuar, do të peshohen në praninë e përfaqësuesit të Kontraktorit dhe përfaqësuesit të AK dhe do hartohet proces-verbali për sasinë e peshuar.

2.3 Dezinfektimi

Kontenierët e mbetjeve spitalore të ripërdorshëm dhe kontenierët për magazinimin e përkohshëm të mbetjeve spitalore të dezinfektohen pas çdo zbrazjeje. Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, nga ana e Kontraktorit do të bëhet dezinfektimi i ambientit nga ku do të tërhiqen mbetjet spitalore të magazinuar prej AK, përfshirë dezinfektimin e frigoriferit dhe ambientit përreth kur është rasti.

2.4 Marrja në dorëzim:

Dorëzuesi dhe marrësi i mbetjeve spitalore plotësojnë dhe mbajnë nga një kopje të firmosur të Dokumentit të Dorëzimit të Mbetjeve (DDM) sipas Shtojcës 1 të VKM nr. 371, datë 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme", i ndryshuar dhe ndryshimeve ligjore që mund të ndodhin.

2.5 Transportimi

Transportimi i mbetjeve spitalore kryhet me mjete të cilat përmbushin dhe respektojnë kërkesat dhe rregullat mbi qarkullimin rrugor, kushtet higjienike, shëndetësore dhe kushtet mjedisore, sipas përcaktimeve të detajuara në Specifikimet Teknike. Mjetet e transportit të mbetjeve spitalore të rrezikshme të jenë të pajisur me Akt-Miratimi Higjieno-Sanitar.

Çdo automjet duhet të pastrohet dhe dizinfektohet tërësisht në pjesën e brendshme të trupit të automjetit pas çdo dite pune si dhe në rast derdhje ose ndotje me ndonjë mbetje spitalore.

Automjetet duhet të mos përdoren për qëllim tjetër përveç transportimit të mbetjeve spitalore. Gjatë transportimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme, automjetet të mbajnë me vete veshje të mjaftueshme të sigurinë, pajisje të dekontaminimit dhe pastrimit dhe materiale

për trajtimin e derdhjeve (p.sh. veshjet mbrojtëse personale, qese plastike dhe kuti të mprehtash rezervë, dezinfektues, kokrriza absorbuese, furça, fshesa lecke, lopatë dhe kova.

3 Trajtimi i mbetjeve spitalore të rrezikshme

Kontraktori, në cilësinë e marrësit të mbetjeve spitalore duhet të jetë i pajisur gjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit me Licencë, Leje të Mjedisit dhe Akt-Miratim Higjiëno-Sanitar, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Trajtimi i mbetjeve spitalore kryhet nga subjektet e licencuar, në impiantet për trajtimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme, që duhet të jenë të licensuar dhe të respektojnë kërkesat sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat.

Pajisja me leje mjedisore dhe licensë përkatëse e operatorëve ekonomik dhe impianteve për trajtimin e mbetjeve është kusht për kualifikimin. Lejet Mjedisore përkatëse duhet të përmbajnë të dhëna të detajuara që identifikojnë qartë: metodën e trajtimit, teknologjinë e impianteve, llojin dhe tipin e impiantit, vendndodhjen, kapacitetet, ciklet dhe proceset e punës së impianteve.

A. Trajtimi i mbetjeve spitalore të kryhet me metoda të standartizuara. Proceset bazë për trajtimin e mbetjeve spitalore janë si vijon:

- i. termik: ky proces përdor energjinë termike për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- ii. kimik: ky proces përdor dezinfektantë si dioksid klori i tretur, hipoklorit natriumi, acid peracetik, solucion gëlqereje, gaz ozoni ose kimikate të thata inorganike (p.sh. pluhur oksid kalciumi) për të shkatërruar patogjenët në mbetje.
- iii. mekanik: ky proces përfshin copëtimin, bluarjen, përzierjen dhe ngjeshjen me qëllim përmirësimin e shkallës së transferimit të nxehtësisë, depërtimit të avullit dhe kontaktit me dezinfektantin kimik si dhe për të zvogëluar vëllimin e mbetjeve, për t'i bërë mbetjet e trajtuara të panjohshme ose për të shmangur dëmtimin fizik në rastin e mbetjeve të mprehta të trajtuara. Ky proces nuk mund të shkatërrojë patogjenët, por plotëson proceset e tjera të trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme.

B. Llojet e pranueshme të teknologjive për trajtimin e mbetjeve spitalore

a. Teknologjitë termike pa djegie

- i. Autoklavat – trajtimi kryhet përmes nxehjes së mbetjeve nga avulli nën presion.
- ii. Sistemet e integruara (ose autoklava të avancuara apo autoklava hibride) - kombinojnë trajtimin me avull me procese të tjera mekanike si ngjeshje, copëtim, grirje, para, gjatë ose pas trajtimit;
- iii. Trajtimi me nxehtësinë e fërkimit - përdor nxehtësinë e fërkimit të plotësuar nga ngrohësit me rezistencë për të nxehur mbeturinat, ndërkohë mbetjet copohen në kokrriza të thata.
- iv. Sistemet e nxehtësisë së thatë – nxehtësia aplikohet pa shtuar avull ose ujë. Mbetjet nxehen nëpërmjet përçimit, konveksionit natyror ose të detyruar dhe/ose rrezatimit termik.

b. Teknologjitë kimike

- i. Hidroliza alkaline - shndërron mbetjet patologjike në një tretësirë ujore të dekontaminuar.

c. Teknologjitë me djegie.

- i. Inceneratorët – trajtimi bazohet në procesin e oksidimit të thatë dhe temperaturës së lartë që kthen mbetjet organike dhe të djegshme në lëndë inorganike dhe të padjeshme dhe që rezultojnë në një reduktim të ndjeshëm të vëllimit dhe peshës së mbetjeve”.

C. Kontraktori dokumenton dhe regjistron në një regjistër të posaçëm, transferimet e mbetjeve siç përcaktohet në VKM nr. 371, datë 11.6.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre” i ndryshuar, VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit” i ndryshuar si dhe në Urdhërin e Ministrit të Mjedisit nr.135, datë 16.4.2015 “Për miratimin e mënyrës së administrimit të formatit të regjistrit të transfertave individuale dhe të regjistikombëtar të transfertave, si dhe mënyrën e administrimit të tyre”.D. Asgjesimi i tepricave që rezultojnë nga trajtimi i mbetjeve spitalore

Kontraktori është përgjegjës për tu siguruar për evadimin përfundimtar me asgjesim të tepricave që rezultojnë pas trajtimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Procesi i asgjesimit të tepricave, mund të realizohet nga vetë Kontraktori, nëse është i pajisur me Leje Mjedisore dhe Licensën përkatëse për këtë proces, ose nga subjekte të tjera të pajisur me Leje Mjedisore e Licensë përkatëse, me të cilët Kontraktori duhet të ketë kontratë aktive në momentin e dorëzimit të ofertave dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Kuadër do të jete përgjegjës që të mundesoje që ky shërbim të vazhdojë sipas standarteve dhe rregullave në fuqi.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë të sterilizuara:

- d) mund të dërgohen për rikuperim në impiantet termike të prodhimit të energjisë;
- e) mund të asgjësohen në impiantet e djegies së mbetjeve urbane ose në impiantet speciale të djegies së mbetjeve;
- f) nëse nuk ka impiante sipas gërmeve a) dhe b), mund asgjësohen në landfille për mbetjet jo të rrezikshme.

Tepricat e gjeneruara pas trajtimit të mbetjeve spitalore, që rezultojnë HI

Hiri nga incineratori dhe tepricat e tjera të ngurta të prodhuara, depozitohen në landfille për mbetje jo të rrezikshme, nëse testet vërtetojnë se nuk paraqesin rrezik sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për mbetjet. Në të kundërt, trajtohen si mbetje të rrezikshme dhe mund të depozitohen në landfille për mbetje të rrezikshme, ose të magazinohen nga Kontraktori deri sa të kontraktojë landfillin e mbetjeve të rrezikshme, ose në pamundësi të disponueshmërisë së një landfilli të mbetjeve të rrezikshme, të realizojë procedurat e nevojshme për eksportin e tyre, dhe ti dokumentojë procesin.

Autoritetit Kontraktor për procesin e asgjësimit të tepricave të mbetjeve spitalore, kur asgjësuesi i tyre është i ndryshëm nga Kontraktori, dokumenton dhe regjistrohen në një regjistër minimalisht të dhënat e mëposhtme:

- f. Të dhënat e kontaktit (emër, mbiemër, adresë, nr. telefoni) të dorëzuesit të mbetjeve spitalore;
- g. Llojin e mbetjeve të trajtuara dhe kodin përkatës sipas katalogut shqiptar të mbetjeve;
- h. Sasinë e dorëzuar të tepricave të mbetjeve (në kg);
- i. Datën e dorëzimit;
- j. Numrin e lejes së mjedisit, numrin e licencës III.2.B dhe Kodin unik të dorëzuesit të tepricave të mbetjeve spitalore të trajtuara të dorëzuara për asgjësim;

Në çdo rast të sipërpërmendur mbahet parasysh parashikimi i nenit 44, të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, për të përjashtuar nga depozitimi në landfill mbetjet spitalore të patrajuara fillimisht në impiante të trajtimit të mbetjeve spitalore.

d. Monitorimi

Autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të kontratës së lidhur me OE fitues është përgjegjës për plotësimin e kërkesave për procesin e përzgjedhjes së subjektit të licensuar dhe për monitorimin e respektimit të detyrimeve nga OE. Për këtë, subjekti i licensuar i kontraktuar detyrohet t'i dorëzojë prodhuesit të mbetjeve, nëse është e mundur në çdo marrje në dorëzim pasardhëse të mbetjeve spitalore, por jo më vonë se 2 (dy) muaj nga marrja në dorëzim e tyre, dokumentacionin për realizimin e proceseve të menaxhimit të mbetjeve spitalore të kontraktuara.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë

SASITË E PARASHIKUARA

Nr	Transport dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme spitalore	Menyra e trajtimit per cdo rryme	Njësia	Sasia e pritshme për 12 muaj
1	Kodi : 180101 Bisturitë, shiringa, instrumenta të mprehtë (përves 18 01 03)	Sterilizim, grirje, proces mekanik, ndryshim i formes fizike	kg	800
2	Kodi : 180102 Pjesë të trupit dhe organe përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përves 18 01 03)	incenerim	kg	530
3	Kodi : 180103 Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të vecantë për të parandaluar infeksionet.	sterilizim ose incenerim	kg	7,600
4	Kodi: 180104 Mbetjet grumbullimi dhe asgjësimi i te cilave nuk kerkon trajtim te vecante per te parandaluar infeksionet , (p.sh. veshje, hedhurinat e leukoplasteve nderresat, veshje per te asgjësuar, pelena, etj)		kg	600
5	Kodi : 180109 Medikamente të tjera përvec atyre të përmendura në 18 01 08	incenerim	kg	350
Totali i sasisë				9,880

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit përfundimtar.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 08.07.2024 Ora: 10:00; Vendi: www.app.gov.al, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Sarandë .

NJËSIA E PROKURIMIT: